



Data: 16.04.2019

Ref.: 60/19 D

Bazuar në nenin 7, dhe 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), nenin 47 dhe 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Nr. 621/18D, datë 12.06.2018, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 68-të, të mbajtur më 10 prill 2019, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet pjesërisht ankesa Nr.506/19H, datë 27.03.2019 e Kolegjit UBT, si e bazuar.
2. Anulohet pika 1.4 e vendimit të KSHC-së Nr.305/19D, datë 25.02.2019 me te cilën është tërhequr akreditimi i programit të studimit, Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc, 180 ECTS (dega në Prizren).
3. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së Nr. Nr.305/19D, datë 25.02.2019 mbetet e pa ndryshuar.

Arsyetimi

KSHC me vendim Nr.305/19D, datë 25.02.2019 ka tërhequr akreditimin e programeve të studimit si në vijim: Arkitekturë dhe Planifik Hapësinor, BSc, 180 ECTS (dega në Prizren); Infermieri, BSc, 180 ECTS; Media dhe Komunikim, MA, 120 ECTS; Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc, 180 ECTS (dega në Prizren), dhe Sistemet e Informacionit, BA, 180 ECTS.

Kolegji UBT, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të KShC-së Nr.305/19D, datë 25.02.2019. Ankesa është dorëzuar në AKA me datë me datë 27.03.2019. Kjo ankesë është trajtuar duke u bazuar në Neni 128 (Adresimi i ankesës) dhe 131 (Procedura e shqyrtimit të ankesës nga organi kompetent publik) të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016).

Përmes kësaj ankesa, Kolegji UBT ka parashtruar faktet relevante dhe ka ofruar dëshmi rreth kualifikimit dhe fushës së studimit për stafin akademik për programin e studimit, Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc, 180 ECTS (dega në Prizren), i cilat ka qenë objekt i trajtimit me vendimin e KSHC-së Nr.305/19D, datë 25.02.2019.

Te gjitha dëshmitë e ofruara në ankesë për këtë program të studimit, janë trajtuar dhe vlerësuar në mbledhjen e 68-të të KShC-së, të mbajtur me 10 prill 2019, dhe në fund, KShC erdhi në përfundim që ankesa

është pjesërisht e bazuar, dhe që stafi akademik i prezantuar përmes ankesës për programin e studimit, Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc, 180 ECTS (dega në Prizren), i plotëson kushtet për të qen bartës të programit të studimit, dhe mbi këtë bazë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Pjesën tjetër të ankesës për programet e studimit: : Arkitekturë dhe Planifik Hapësinor, BSc, 180 ECTS (dega në Prizren); Infermieri, BSc, 180 ECTS; Media dhe Komunikim, MA, 120 ECTS; dhe Sistemet e Informacionit, BA, 180 ECTS, KSHC vendosi që këtë çështje ta referoj për vendimmarrje në Komisionin e Ankesave, bazuar në pikën pesë të nenit 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, brenda afatit prej 30 ditësh nga momenti i pranimt të këtij vendimi. Ky vendim është përfundimtar, dhe iniciimi i procedurave gjyqësore nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Kolegji UBT;
- MASHT-it, dhe
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

